

KË

KËRKESË
Nr. 898, datë 2.7.2020

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT
“SHUAIP SEJKO”

ISHSH-ja, Dega Rajonale e Qarkut Vlorë, meqenëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar: i panjohur.

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale e Qarkut Vlorë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH VL-2019 002019 - 5, datë 20.8.2019, për subjektin “Shuaip Sejko”, hotel-bar-restorant, me adresë: rruga “Butrinti”, lagjja nr. 1, Sarandë.

KRYEINSPEKTOR
Lorenc Rexha

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-VL-2019-002019 - 5

Datë 20.8.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe në procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-VL-2019-002019-2, datë 20.8.2019, inspektim, që është zhvilluar në subjektin “Shuaip Sejko”, NIPT K83907801E, përfaqësues i autorizuar i subjektit “Shuaip Sejko”, prej datës 30.7.2019 deri më datën 30.7.2019.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 20.8.2019 dhe e njoftoi në datë 20.8.2019. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit, rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: ligji n. 7643, datë 2.12.1992, “Për inspektimin sanitar” (i ndryshuar), neni 12.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit *nuk ka*, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Paralajmërim.

2. Dënim administrativ plotësues:

- Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 48, pika 6: Moskorrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar shoqërohet me dënim plotësues “gjobë” me vlerën 20000.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive.

6.9.2019 – Të pajiset me akt miratim higjieno-sanitar.

Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave.

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:
Elona Mano ID_



Arqile Kaishi ID_



Personi i autorizuar i subjektit

Shuaip Sejko

Shuaip Sejko



Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti “Shuaip Sejko” ka të drejtën e ankimit, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.